

VENDIM
Nr. 607, datë 27.10.2017

PËR KALIMIN E MJEDISEVE
TË NDËRTESES “GODINA E INOVACIONIT” NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË
SË INFORMACIONIT (AKSHI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ndërtesës “Godina e inovacionit”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali”, nr. 3, kalojnë në përgjegjësi administrimi tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për mjedise pune, për ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative, sipas planimetrisë, dhënë në anekset bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- Aneksi 1, në katin nëntokë (-1), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 546 (pesëqind e dyzet e gjashtë) m², sipërfaqja 490 (katërqind e nëntëdhjetë) m² dhe sipërfaqja 535 (pesëqind e tridhjetë e pesë) m².

- Aneksi 2, në katin përdhes (0), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 937 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë) m², sipërfaqja 90 (nëntëdhjetë) m², sipërfaqja 90 (nëntëdhjetë) m² dhe sipërfaqja 454 (katërqind e pesëdhjetë e katër) m².

- Aneksi 3, në katin e parë (1), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 815 (tetëqind e pesëmbëdhjetë) m², sipërfaqja 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m² dhe sipërfaqja 385 (treqind e tetëdhjetë e pesë) m².

- Aneksi 4, në katin e dytë (2), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 700 (shtatëqind) m² dhe sipërfaqja 871 (tetëqind e shtatëdhjetë e një) m².

2. Në katin e parë (1), mjedisi me sipërfaqe 815 (tetëqind e pesëmbëdhjetë) m² t'i jepet në përdorim për një afat të pacaktuar Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.

3. Në katin e parë (1), mjedisi me sipërfaqe 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m² t'i jepet në përdorim deri më 31 dhjetor 2018 qendrës “Protik ICT Resource Center” për ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative.

4. Në katin e parë (1), mjedisi me sipërfaqe 385 (treqind e tetëdhjetë e pesë) m² t'i jepet në përdorim për një afat të pacaktuar Komisionit të Prokurimit Publik për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.

5. Në katin e dytë (2), mjedisi me sipërfaqe 700 (shtatëqind) m² t'i jepet në përdorim për një afat të pacaktuar Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.

6. Vendimi nr. 34, datë 20.1.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 871 m², në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), projekti “Innovation Hub”, shfuqizohet.

7. Vendimi nr. 974, datë 2.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) e të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe në përdorim të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) e të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), të mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-Inima”, shfuqizohet.


8. Institucioneve të cilat kanë në përgjegjësi administrimi apo në përdorim mjediset e godinës, u ndaloher të ndryshojnë destinacionin e pronës, t'i tjetërsojnë ato apo t'ua japin në përdorim të tretëve.

9. Ngarkohen Kryeministria, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 1
KATI NENTOKE (-1)



GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 2
KATI PERDHE (0)



GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 3
KATI PARE (1)



GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 4
KATI DYTE (2)

